VENDIM
Nr. 362, datë 20.6.2018

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSION I BLLOKUT TË PALLATEVE NË XHABIJE", BASHKIA SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i bllokut të pallateve në Xhabije", Bashkia Shkodër.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Shkodër.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë "tokë truall", me sipërfaqe 906.35 (nëntëqind e gjashtë pikë tridhjetë e pesë) m^2, dhe "ndërtesë", me sipërfaqe 354.05 (treqind e pesëdhjetë e katër pikë zero pesë) m^2, me një vlerë të përgjithshme të shpronësimit prej 25 706 471.8 (njëzet e pesë milionë e shtatëqind e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë) lekësh.

4. Pronarët e përmendur në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Shkodër.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 25 706 471.8 (njëzet e pesë milionë e shtatëqind e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Shkodër, planifikuar në buxhetin e saj.

6. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Shkodër.

7. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë Shkodër të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër dhe Bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

LISTA E PRONAVE DHE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "RIKONSTRUKSION I BLLOKUT TË PALLATEVE XHABIJE"

Bashkia Shkodër

Nr.	Emri, mbiemri (pronari që shpronësohet)	Indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Vol.	Sipërfaqe totale m²	Nga kjo s. trualli m²	Çmimi i truallit lekë/m²	Vlera e truallit lekë	Sip, ndërtimi m²	Çmimi i ndërtesës lekë/m²	Vlera e ndërtesës lekë	Vlera totale	Shënime
1	Bujar Zeneli	Sh-0-6	1/533	28	89.25	89.25			89.25	58,687.50	5,237,859.38	5,237,859.4	Konfirmim ZVRPP Shkodër
2	Martin Kodra		1/755	38	25.9	25.9			25.9	58,687.5	1,520,006.25	1,520,006.3	Konfirmim ZVRPP Shkodër
3	Lekë Lekaj		1/745		18	18			18	58,687.5	1,056,375.00	1,056,375.0	Vërtetim nga dok. hipotekor
4	Vaçe Mlika Valbona Topaku	SH-P-6	1/790	38	37.9	37.9			37.9	58,687.5	2,224,256.25	2,224,256.3	Vërtetim nga dok. hipotekor
6	Ruzhdi Pjeshka Pranvera Pjeshka	SH-0-6	1/943	36		35	12,223	427,805.0				427,805.0	Vërtetim nga dok. hipotekor
8	Isuf Haxhija	SH-0-7	1/935	35		90	12,223	1,100,070.0				1,100,070.0	Vërtetim nga dokumenti hipotekor
9	Ali Haxhija Emine Haxhija Ahmet Haxhija Fatime Çakiçi Albana Zeneli Anila Mesi					450	12,223	5,500,350.0				5,500,350.0	Vërtetim nga dokumenti hipotekor
7	Esad Bushati	SH-0-6	1/546	30		6	12,223	73,338.0				73,338.0	Konfirmim ZVRPP Shkodër
10	Afrim Bushi Emil Bushi	SH-P-6	1/356-ND	26	25,4		12223	0.0	25.4		745,719	745,719.0	Konfirmim ZVRPP Shkodër
11	Ejell Markaj	SH-P-6	1/23		226	28.75	12,223	351,411.3	28.75		556,661	908,072.3	Vërtetim nga dok. hipotekor
12	Eranda Naim Krymi Nertila Naim Xama	SH-P-6	1/766	37	30	30			60	58,687.5	3,521,250	3,521,250.0	Konfirmim ZVRPP Shkodër
13	Xhaudet Zagoviq	Sh-P-6	1/549	31	68,85	68.85	12223	841,553.6	68.85		2,223,463	3,065,016.6	Konfirmim ZVRPP Shkodër
14	Dritan Allçeniku	Sh-O-6	1/343		26.7	26.7	12223	326,354.1				326,354.1	Konfirmim ZVRPP Shkodër
	Shuma që shpronësohet					**906.35**		**8,620,882**	**354.05**		**17,085,590**	**25,706,471.8**	